



## NJOFTIM PËR SHTYP

### KONFERENCA "FALCONE E BORSELLINO, 30 VITE MË PAS", 9 MAJ 2022, ORE 17:00, NË QENDRËN KULTURORE TË KATEDRALES ORTODOKSE NË TIRANË

Më datë 9 maj, në orën 17:00, në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokse në Tiranë, Ambasada e Italisë, në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës dhe Ekspertin e Guardia di Finanza-s në Tiranë, do të organizojë Konferencën e rëndësishme përkujtimore me titull "Falcone e Borsellino, 30 vite më pas".

Masakra e Capaci-t dhe ajo e Via D'Amelio-s qenë pika kulmore e sfidës përballë së cilës mafia vendosi institucionet demokratike të Vendit tonë si dhe ngjarjet që tronditën ndërgjegjen e opinionit publik.

30 vite më pas, është detyrë e jona të mbajmë gjallë kujtimin e viktimave e të nderojmë prokurorët të cilët mbartin vlera të mëdha morale, duke vijuar me përqimin e mësimave të tyre. Konferenca do të jetë një moment reflektimi mbi fenomenin e mafias dhe rasti për të ndërgjegjësuar shoqërinë civile e për të promovuar një kulturë ligjshmërie.

Relatorë: Senatori **Alessandro Ruotolo**, ish Drejtori i DAP (Departamenti i Administratës së Burgjeve) **Bernardo Petralia**, Gjeneral Korpusi, Komandanti Ndërrajonal i Italisë së Jugut **Ignazio Gibilaro**, Prokurori pranë Drejtorisë Rajonale Antimafia të Reggio Calabria-s **Gaetano Calogero Paci**, prokurorja **Alessandra Camassa**, famulltari i San Gaetano Catanoso **Don Giovanni Battista Tillicci**. Do të kemi gjithashtu nderin të ndjekim, në lidhje online, dëshminë e **Salvatore Borsellino-s**, vëllait të prokurorit që humbi jetën në masakrën e Via D'Amelio-s.

Diskutimi do të moderohet nga **Giancarlo Costabile**, Profesor i Historisë së Edukimit për demokraci e ligjshmëri pranë Universitetit të Cosenza-s.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, më datë 8 maj, në orën 19:00, në Teatrin Metropol, në Tiranë, do të shfaqet pjesa teatrale me titull "Vera e fundit. Falcone e Borsellino 30 vite më pas", nga Claudio Fava, me regji të Chiara Callegari-t.